




**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA**  
**SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA**



Seancës së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe gjyqtareve të Gjykatës Supreme të EULEX-it, n ë mbledhjen e mbajtur më 19.03.2013 jep këtë:

**Mendim juridik**

*Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore, përkatësisht Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës së Apelit, sipas nenit 13, par1., nënpar.1 të Ligjit për Gjykatat Nr.03/L-199, janë kompetente për t'i gjykuar:*

- a) mosmarrëveshjet e ndërsjella tregtare dhe kompensimet e dëmit mbi të njëjtën bazë ndërmjet shoqërive tregtare (subjekteve ekonomike) vendore apo të huaja;*
- b) mosmarrëveshjet e ndërsjella tregtare ndërmjet:*
- bizneseve individuale,*
  - ortakëve të shoqërisë së ortakërisë, ortakëve të përgjithshëm dhe të kufizuar të shoqërisë komandite,*
  - titullarëve të interesave pronësorë të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (në tekstin e mëtejme : "shpk"),*
  - aksionarëve të shoqërive aksionare (në tekstin e mëtejme : "sh.a.")*
  - drejtorit apo drejtorëve menaxhues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe*
  - Bordit të drejtorëve të shoqërisë aksionare.*

## ARSYETIMI

1. Duke qenë se janë paraqitur disa paqartësi, vështirësi dhe dilema në gjykatat themelore dhe Gjykatën e Apelit lidhur me interpretimin dhe implementimin e dispozitës së nenit 13, par. 1 nënpar. 1 të Ligjit për Gjykatat, që parashikon se Departamenti për çështje ekonomike i gjykatës themelore është kompetent t'i gjykojë mosmarrëveshjet ndërmjet personave juridike vendorë dhe të huaj e duke iu qasur interpretimit dhe implementimit kritik dhe kreativ të kësaj dispozite ligjore dhe një sërë dispozitash ligjore të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (në tekstin e mëtejshëm: "LSHT"), si dhe ligjeve tjera të sferës tregtare rezultojnë detyrimi ligjor sipas nenit 22 par.1 nënpar.3 dhe nenit 23.par 1 të Ligjit për Gjykatat që Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të bëjë njësimin e praktikës juridike gjyqësore dhe të promovojë zbatimin unik të ligjeve, duke ndërtuar standarde dhe praktika të qëndrueshme juridike.
2. Interpretimi kritik dhe kreativ dhe, rrjedhimisht, zgjidhja e dilemave e paqartësive lidhur me këtë dispozitë ligjore, por edhe me dispozitat përkatës të LSHT, si dhe të ligjeve tjera, të cilat në këtë situatë juridike zbatohen *mutatis mutandis*, kanë rëndësi kryesore për njësimin e praktikës juridike – gjyqësore në promovimin e ndërtimit të standardeve, praktikave të qëndrueshme juridike dhe, rrjedhimisht, edhe në forcimin e kredibilitetit dhe imazhit si dhe reputacionit të gjyqësorit të Republikës së Kosovës, me synimin për të arritur sigurinë juridike të palëve, stabilitetin e rendit juridik, pra edhe funksionimin efikas –efektiv të shtetit të së drejtës.
3. Efekti juridik i ndërtimit të këtyre standardeve dhe praktikave të njësuara dhe të qëndrueshme juridike konsiston në performancën pozitive të gjyqësorit, duke përfshirë edhe pritshmërinë dhe kënaqshmërinë e palëve dhe të qytetarëve si dhe, në këtë kuadër, edhe krijimin e një ambienti të qëndrueshëm ekonomik për investitorët vendorë dhe të huaj.
4. Me dispozitat e nenit 13, par. 1 nënpar. 1 të Ligjit për Gjykatat, në tekstin e gjuhës angleze parashikohet: *The Commercial Matters Department of the Basic Court shall be competent for the following matters: disputes between domestic and foreign economic persons in their commercial affairs.*

Ndërkaq, teksti në gjuhën shqipe i së njëjtës dispozitë nuk është i barasvlershëm (ekuivalent) me atë në gjuhën angleze.

5. Përderisa në paragrafin 1, nënpar. 1 të nenit 13 të Ligjit për Gjykatat parashikohet që Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore gjykon mosmarrëveshjet ndërmjet personave juridikë vendorë dhe të jashtëm lidhur me çështjet afariste, teksti në gjuhën angleze, i përkthyer në gjuhën shqipe, parashikon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndërsjella ndërmjet personave ekonomikë lidhur me çështjet e tyre tregtare apo afariste.
6. Duke bërë krahasimin e ekuivalencës së këtyre dy teksteve, rezulton se në tekstin e gjuhës angleze përdoren termet juridiko-teknikë: "Departamenti për çështje tregtare" dhe "personi ekonomik", ndërkaq në tekstin e gjuhës shqipe përdoren nocionet "Departamenti për çështje ekonomike" dhe "personi juridik".
7. Pra, këto dy tekste të nenit 13, par. 1 nënpar. 1 të Ligjit për Gjykatat janë diametralisht të kundërta për nga përmbajtja, kuptimi dhe interpretimi si dhe përdorimi i termave juridiko-teknikë, gjë që krijon dilema, vështirësi dhe paqartësi në interpretim dhe implementim.
8. Në dispozitat e nenit 4, par. 1 të LSHT parashikohen llojet e shoqërive tregtare, si: *Shoqëria tregtare mund të themelohet në Kosovë në formë të ndërmarrjes individuale, ortakërisë së përgjithshme, shoqërisë komandite, shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ose shoqërisë aksionare.*
9. Ndërkaq, në dispozitën e nenit 2, par. 1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në termat e referencës si veprimtari tregtare parashikohet "**veprimtaria tregtare**", do të thotë çdo lloj aktiviteti i rregullt ose aktivitet i përsëritur, që përfshin ofrimin, sigurimin ose prodhimin e mallrave, shërbimeve, pronës dhe/ose punëve për një person ose shoqëri, në këmbim ose në pritje të çfarëdolloj pagese ose kompensimi.
10. Në nenin 12, par. 2 i LMD parashikohet se kontratat komerciale janë kontrata të lidhura nga subjektet komerciale. Pra, në këtë rast na paraqitet nocioni "subjekt komercial", i cili nuk është asgjë tjetër pos sinonim i nocionit "subjekt tregtar" ose "shoqëri tregtare"; ky i fundit është nocion që parashikohet me LSHT.
11. Në neni 3, par. 3 të LMD parashikohet nocioni "entitete afariste" të përcaktuara me ligj që kryejnë veprimtari fitimprurëse dhe konsiderohen subjekte afariste. Edhe këtu kemi të bëjmë me një nocion, i cili paraqet sinonim të "subjektit tregtar" ose "shoqërisë tregtare".
12. Pra, nga fjalorët terminologjikë rezulton se "personi ekonomik" është i barasvlershëm me "shoqërinë tregtare" (subjektin afarist apo subjektin komercial, siç është përdorur në Ligjin e

- Marrëdhënieve të Detyrimeve). Prandaj, edhe nocioni juridik "departamenti për çështje ekonomike" është i barasvlershëm me "departamentin për çështje tregtare".
13. Duke qenë se termat juridiko-teknikë "person ekonomik", "subjekt afarist", gjegjësisht "shoqëri tregtare" sipas dispozitës së nenit 4, par. 1 përfshijnë: ndërmarrjet individuale, ortakëritë e përgjithshme, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare, atëherë rrjedh konkludimi juridik i saktë, i plotë, i qartë, i drejtë dhe i ligjshëm se Departamenti për Çështje Tregtare i Gjykatës Themelore, përkatësisht ai i Gjykatës së Apelit (sipas ankesës) janë kompetente të gjykojnë të gjitha mosmarrëveshjet e ndërsjella tregtare ndërmjet shoqërive tregtare vendore si dhe të këtyre shoqërive me shoqëritë e huaja tregtare. Ligji i Mbrojtjes së Konsumatorit në nenin 3, par. 1, nënpar. 1.2 si subjekt me cilësinë e tregtarit parashikon çdo person fizik apo juridik që shet ose vepron në treg si biznes apo ushtron veprimtarinë e tij tregtare, si person që vepron në emër ose për llogari të një tregtari me shumicë apo të një prodhuesi. Po kështu, edhe në dispozitën e nenit 1, paragrafi 1.18 të Ligjit për Markat Tregtare parashikohet që subjekt afarist është çdo person juridik dhe fizik që ushtron veprimtari tregtare, që është titullar i markës tregtare.
  14. Nocionet juridiko-tregtare të specifikuar me cilësimin "person ekonomik", sipas nenit 13, par. 1 të Ligjit të Gjykatave, përfshijnë shoqëritë tregtare sipas dispozitës së nenit 4, par. 1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare; ky term juridik është kompatibël me të gjitha standardet dhe praktikatat e ligjeve të shteteve të BE, sidomos të Ligjit të Shoqërive Tregtare të RF të Gjermanisë, ligj ky që ka shërbyer si model i hartimit dhe miratimit të ligjit tonë me të njëjtin emërtim.
  15. Republika e Shqipërisë, por edhe shtetet që kanë dalë nga ish Jugosllavia, me ligjet e tyre përkatëse për shoqëritë tregtare, çështjen e kompetencës së gjykatave tregtare, të degëve të gjykatave tregtare apo të organizimeve të tilla të ngjashme i kanë rregulluar në atë mënyrë që këto gjykata i gjykojnë të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet shoqërive tregtare nga veprimtaria e tyre tregtare.
  16. Emërtimi i nocionit juridik si "veprimtari e ligjshme e shoqërive tregtare" përfshin në vete markën tregtare (trademark) që është e barasvlershme me zinxhirin prodhues dhe këmbyes të tregtimit, ndaj edhe duhet përdorur termi juridik "veprimtari tregtare", duke përjashtuar termat e tjerë, siç janë termat "veprimtari ekonomike" a "veprimtari afariste".
  17. Neni 13, par. 1 nënpar. 1 i Ligjit për Gjykatat është ndërtuar me attribute joprofesionale, në mungesë të standardeve të përgjegjësisë profesionale dhe si reflektim i formulimeve

stereotipe të ndikuara nga nenit 30, par. 1 nënpar. a) të Ligjit të Gjykatave të vitit 1978, i cili ka parashikuar që gjykatat i zgjidhin kontestet mes personave juridikë në rrethanat e ekzistimit të pronës shoqërore dhe etatizmit socialist. Prandaj, ato formulime që i referoheshin kompetencës së gjykatës ekonomike janë edhe peng i së kaluarës.

18. Prandaj, nisur nga ky këndvështrim, rezulton që Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore është kompetent t'i gjykojë mosmarrëveshjet e ndërsjella tregtare lidhur me veprimtarinë e ligjshme tregtare brendapërbrenda shoqërive tregtare apo subjekteve afariste, që u referohen ortakëve të përgjithshëm të ortakërisë së përgjithshme dhe ortakëve të përgjithshëm dhe me përgjegjësi të kufizuar të shoqërisë komandite, titullarëve të interesave pronësore të SHPK-ve, aksionarëve të SHA-ve, drejtorit menaxhues të SPK-së dhe bordit të drejtorëve të SHA-së.

19. Po kështu, Departamenti për Çështje Tregtare i Gjykatës Themelore dhe ai i Gjykatës së Apelit i gjykojnë të gjitha mosmarrëveshjet e ndërsjella nga veprimtaria tregtare e subjekteve tregtare të përmendura në paragrafin paraparak, si në vijim:

20.

- a) neni 17, par. 4 dhe 5 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare i referohet paraqitjes së ankesës nga pala e pakënaqur kundër vendimit të Komisionit për Ankesa Administrative të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë,
- b) neni 61 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare, nga paditë individuale dhe derivateve, kur shkelen të drejtat e titullarëve të interesave pronësore të shoqërisë apo ortakëve të parashikuara me marrëveshjen e kësaj shoqërie,
- c) neni 69, par. 3 – kur ortakëve me përgjegjësi të kufizuar u mohohet inspektimi i raporteve dhe tregueseve të tjerë financiarë, atëherë titullari ka të drejtë të paraqesë padi për sigurimin e atyre të dhënave,
- d) neni 72 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare – kur ortakut me përgjegjësi të kufizuar i pamundësohet kalimi i interesit pronësor te personi i tretë, ai ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore,
- e) neni 88, par. 12 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare – kur titullarit të interesit pronësor i pamundësohet e drejta për qasje në informata, atëherë ai mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore.
- f) neni 104 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare – kur pronarit të interesit pronësor i pamundësohet tërheqja nga shoqëria apo shoqëria e përjashton nga shoqëria, atëherë ai gëzon mbrojtje gjyqësore për mbrojtjen e interesave pronësore.

- g) neni 115 Ligjit për Shoqëritë Tregtare – kur secili pronar i shoqërisë ka të drejtë të paraqesë padi individuale apo derivateve, kur drejtori menaxhues apo bordi i drejtorëve ka shkelur parimet e kujdesit dhe vlerësimit afarist, detyrimin për lojalitet dhe detyrimin për moskonkurrencë apo përgjithësisht kur shoqërisë i ka shkaktuar dëm me veprime të paligjshme.
- h) neni 123 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare – kur parashikohet që plani i bashkimit qoftë i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, qoftë i shoqërisë aksionare i shkel dispozitat ligjore apo interesin pronësor dhe, rrjedhimisht, aksionet e aksionarit, atëherë pala e pakënaqur paraqet padi në gjykatë për mbrojtje gjyqësore, dhe
- i) neni 191, par. 3 i LSHT ku parashikohet që gjykata, me vendim përkatës sipas kërkesë së Bordit të drejtorëve apo aksionarit, të urdhërojë mbajtjen e kuvendit të aksionarëve, nëse ajo nuk mbahet në afat prej 6 muajsh pas përfundimit të vitit financiar, 14 muaj pas mbledhjes së fundit të Kuvendit të aksionarëve dhe 12 muaj pas regjistrimit fillestar të shoqërisë.

Nga sa u parashtrua, janë sqaruar dilemat, paqartësitë – formulimet e ngatërruara kuptimore si dhe përdorimi i ngatërruar i termave juridiko-teknikë përkitazi me kompetencën e Departamentit për çështje tregtare të gjykatës themelore, përkatësisht (sipas ankesës) të të njëjtit departament të gjykatës së apelit t'i gjykojnë mosmarrëveshjet e ndërsjella të shoqërive tregtare të parashikuara si në dispozitiv të këtij qëndrimi juridik parimor.

KRYETARI I GJYKATËS

Prof. dr. Fejzullah Hasani

